



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 133

Tiranë – E premte, 7 tetor 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 13, datë 5.10.2022	Për miratimin e tekstit të amendimit të katërt në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet <i>Pfizer Export B.V.</i> dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të ndryshuar.....	16713
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 622, datë 28.9.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 200, datë 15.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të Policisë së Shtetit”, të ndryshuar.....	16713
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 626, datë 28.9.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 920, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë e shtesa mbi pagë dhe për procedurën e kompensimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësve të Policisë së Burgjeve”.....	16714
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 633, datë 28.9.2022	Për ngarkimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurës së prokurimit publik për zbatimin e projektit për vendosjen e paneleve fotovoltaike në tarracën e Kryeministrit dhe të ministrave të linjës.....	16715
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 637, datë 5.10.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 867, datë 12.12.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtimi i rrugës paralele ‘Tiranë–Vorë’ (krahu i majtë)’”.....	16715
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 638, datë 5.10.2022	Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar.....	16717

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 639, datë 5.10.2022	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat Shqiptare – rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, në kuadër të grantit të investimit nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor, ratifikuar me ligjin nr. 52/2018.....	16732
Vendim i Këshillit të ministrave nr. 640, datë 5.10.2022	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat Shqiptare – rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, ratifikuar me ligjin nr. 29/2017	16735
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 641, datë 5.10.2022	Për një shtesë në numrin e punonjësve organikë të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për vitin 2022.....	16736
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 642, datë 5.10.2022	Për emërimin në detyrë të kryetarit të agjencisë kombëtare të trajtimit të koncesioneve.....	16736
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 643, datë 5.10.2022	Për përcaktimin e përbërjes dhe të mënyrës së funksionimit të Komitetit për Planifikimin Kombëtar Spitalor.....	16737
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 644, datë 5.10.2022	Për miratimin e marrëveshjes për bashkëpunim në fushën e njohjes së ndërsjellë të diplomave dhe gradave shkencore, të lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e tjera të autorizuar në Ballkanin Perëndimor.....	16737
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 645, datë 5.10.2022	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Kulturës	16739

**AKT NORMATIV**
Nr. 13, datë 5.10.2022

**PËR MIRATIMIN E TEKSTIT TË
AMENDIMIT TË KATËRT NË
MARRËVESHJEN PËR PRODHIMIN
DHE FURNIZIMIN NGA DHE
NDËRMJET *PFIZER EXPORT B.V.* DHE
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË,
MINISTRIT TË SHTETIT PËR
RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË
SHËNDETIT PUBLIK, MIRATUAR ME
AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË
18.1.2021, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**Neni 1**

Miratimin e tekstit të amendimit të katërt në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.*, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të ndryshuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 2**Hyrja në fuqi**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 622, datë 28.9.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 200, DATË 15.3.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME
PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË
PUNONJËSVE TË POLICISË SË
SHTETIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të pikave 1, shkronja “a”, dhe 2, të nenit 67, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1 e vendimit nr. 200, datë 15.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2022, përballohen nga fondet e miratuara me aktin normativ nr. 12, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021, ‘Për buxhetin e vitit 2022’, të ndryshuar”, në kuadër të paketës së rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shtator 2022.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Lidhja nr. 1

PAGA BAZË PËR GRADË PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT

Grada	Paga bazë për gradë
Inspektor	57.500
Inspektor i dytë	59.800
Inspektor i parë	62.680
Nënkomisar	70.000
Komisar	77.000
Kryekomisar	87.000
Drejtues	99.000
Drejtues i parë	103.000
Drejtues i lartë	115.000
Drejtues madhor	125.000

VENDIM

Nr. 626, datë 28.9.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 920, DATË 25.11.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME PAGË E SHITESA MBI PAGË DHE PËR PROCEDURËN E KOMPENSIMIT FINANCIAR GJATË QËNDRIMIT NË PUNË TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË BURGJEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1 e vendimit nr. 920, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2022, përballohen nga fondet e miratuara me aktin normativ nr. 12, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021, ‘Për buxhetin e vitit 2022’, të ndryshuar”, në kuadër të paketës së rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shtator 2022.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Lidhja nr. 1

PAGA BAZË MUJORE PËR GRADË PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË BURGJEVE

Roli	Grada	Paga bazë për gradë
1	2	3
Bazë	Aspirant	53.500
	Nënspektor	55.700
	Inspektor	58.400
	Kryeinspektor	64.000



I mesëm	Nënkomisar	70.000
	Komisar	77.000
	Kryekomisar	99.000
I lartë	Drejtues	115.000
	Drejtues i Lartë	125.000

VENDIM**Nr. 633, datë 28.9.2022**

**PËR NGARKIMIN E FONDIT
SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT, SI ORGAN
QENDROR BLERËS, PËR KRYERJEN E
PROCEDURËS SË PROKURIMIT
PUBLIK PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT
PËR VENDOSJEN E PANELEVE
FOTOVOLTAIKE NË TARRACËN E
KRYEMINISTRISË DHE TË
MINISTRIVE TË LINJËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë e të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si organ qendror blerës dhe njësi zbatuese, për kryerjen e procedurës së prokurimit publik për zbatimin e projektit për vendosjen e paneleve fotovoltaike në tarracën e Kryeministrisë dhe të ministrive të linjës.

2. Në funksion të zbatimit të projektit të përcaktuar në pikën 1, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ngarkohet të kryejë:

a) të gjitha procedurat, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, duke lidhur edhe kontratën përkatëse, si dhe të ndjekë zbatimin e saj e të projektit përkatës;

b) paraqitjen, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë e të ministrive të linjës, të kërkesave për miratimin e lejeve përkatëse.

3. Efektet financiare përballohen nga buxheti i miratuar për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, për vitin 2022.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR

Edi Rama**VENDIM****Nr. 637, datë 5.10.2022**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 867, DATË 12.12.2007,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT ‘NDËRTIMI I RRUGËS
PARALELE ‘TIRANË-VORË’
(KRAHU I MAJTË)’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 867, datë 12.12.2007, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Kudo në vendim, emërtimi “Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve” zëvendësohet me “Autoriteti Rrugor Shqiptar”.

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë,



sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 63 946 (gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e dyzet e gjashtë) m², tokë arë, të vlerësuar me çmimet 4 281 lekë/m², 3 000 lekë/m², 2 538 lekë/m², 448 lekë/m², me vlerë 230 900 730 (dyqind e tridhjetë milionë e nëntëqind mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekësh, për sipërfaqen 8 142 (tetë mijë e njëqind e dyzet e dy) m², tokë truall, të vlerësuar me çmimet 14 602 lekë/m² dhe 3 116 lekë/m², me vlerë 74 071 112 (shtatëdhjetë e katër milionë e shtatëdhjetë e një mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekë, për objekte, me vlerë 19 704 189 (nëntëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 324 676 031 (treqind e njëzet e katër milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tridhjetë e një) lekësh.”.

c) Në pikën 4, vlera “... 445 000 (katërqind e dyzet e pesë mijë) lekë ...” zëvendësohet me “... 495 000 (katërqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) lekë ...”.

ç) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 324 676 031 (treqind e njëzet e katër milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tridhjetë e një) lekësh, të përballohet në masën:

- 324 063 167 (treqind e njëzet e katër milionë e gjashtëdhjetë e tre mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e

shtatë) lekë nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave në “Bankën e Shqipërisë;

- 612 864 (gjashtëqind e dymbëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë, nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.”.

d) Pas tabelës bashkëlidhur vendimit shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë-Vorë, të pasqyrojë në kartelat e pasurive të paluajtshme, në hartat treguese sipas sistemit të regjistrimit, pasuritë e shpronësuara në emër të ARRSH-së pas miratimit të shpronësimit për interes publik të pasurive, pronë private, si dhe pasuritë e llojit “arë” që u mbeten subjekteve pas shpronësimit.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

LISTA EMËRORE SHITESË E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PËR PRONAT TË CILAT PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “NDËRTIMI I RRUGËS PARALELE “TIRANË-VORË” (KRAHU I MAJTË)”

Nr.	PRONARI			Zona kad.	Numri i pasurisë	Sip. totale	Lloji i pas.	Sipërfaqe shpronësimi	Çmimi lek/(m ²)	Vlera (lek)	Shënime	Adresa
	Emri	Atësia	Mbiemri									
1	Eugen	Ali	Elezaj	3974	243/29	5000	arë	1021	448	457,408	Konfirmuar nga ASHK-ja	Tiranë
2	Eugen	Ali	Elezaj	3974	247/80	1254	arë	347	448	155,456	Konfirmuar nga ASHK-ja	Rruga e Kavajës, lagjja 1, godina, hyrja, apartamenti
Vlera totale paraprake										612,864		

**VENDIM****Nr. 638, datë 5.10.2022**

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN, PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, dhe 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në kreun I bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 3, pas fjalëve “... (CFSP) 2022/240 ...” shtohen “... (CFSP)2022/837 dhe (CFSP) 2022/950 ...”.

b) Në fund të pikës 16 shtohen fjalët “... i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2022/1241.”.

2. Në aneksin 3 shtohen vendimet (CFSP) 2022/837 dhe (CFSP) 2022/950, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Në aneksin 16 shtohet vendimi (CFSP) 2022/1241, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen institucionet e parashikuara në nenin 11, pika 1, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe organet përgjegjëse të parashikuara në pikën 1, të nenit 7, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



30.05.2022

Shqip

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian

L147 I/3

VENDIMET

VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2022/837

i datës 30 maj 2022

për ndryshimin e Vendimit (CFSP) 2016/1693 në lidhje me masat kufizuese kundër ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaedës dhe personave, grupeve, ndërmarrjeve dhe subjekteve të lidhura me ta

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë,

duke pasur parasysh:

- (1) Më 20 shtator 2016, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2016/1693 ⁽¹⁾.
- (2) Duke pasur parasysh kërcënimin e vazhdueshëm të paraqitur nga ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaeda dhe personat, grupet, ndërmarrjet dhe subjektet e lidhura me ta, dy persona dhe një grup duhet të shtohen në listën e personave, grupeve, ndërmarrjeve dhe subjekteve të përcaktuara në Aneksin e Vendimit (CFSP) 2016/1693.
- (3) Prandaj, Vendimi (CFSP) 2016/1693 duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Aneksi i Vendimit (CFSP) 2016/1693 është ndryshuar siç përcaktohet në Aneksin e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bërë në Bruksel, 30 maj 2022.

*Për Këshillin
Presidenti
C. KOLONA*



ANEKSI

Aneksi i Vendimit (CFSP) 2016/1693 është ndryshuar si më poshtë:

(1) shënimet e mëposhtme janë shtuar nën titullin 'A. Personat e përmendur në nenet 2 dhe 3':

- '10. Faruq AL-SURI (a.k.a. Samir Hijazi, Samir 'Abd al-Latif Hijazi, Abu Hammam Al-Shami, Abu Humam Al-Shami, Abu Hammam Al-'Askari); data e lindjes: 1977; vendi i lindjes: Damask, Siri; Gjinia mashkull; kombësia: sirian (e supozuar).
11. Sami AL-ARIDI (a.k.a. Abu Mohammad Al-Shami, Abu Mahmud Al-Sham, Abu Mahmud Al-Shami, Sami Al-Oride, Sami Al-Oraid, Sami Al-Oraydi, Sheikh Dr. Sami Al-Uraydi); data e lindjes: 1973; Gjinia mashkull; kombësia: jordaneze (e supozuar).';

(2) të dhënat e mëposhtme shtohet nën titullin 'B. Grupet, ndërmarrjet dhe subjektet e përmendura në nenin 3':

- '3. Hurras AL-DIN (HaD) (a.k.a. Hurras al-Deen, Huras-al-Din, Guardians of Religion, Tanzim Hurras Al-Din, Tandhim Hurras Al-Deen, Sham Al-Ribat, Al-Qaida in Syria, AQ-S).';



DECISIONS

COUNCIL DECISION (CFSP) 2022/837

of 30 May 2022

amending Decision (CFSP) 2016/1693 concerning restrictive measures against ISIL (Da'esh) and Al-Qaeda and persons, groups, undertakings and entities associated with them

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 20 September 2016, the Council adopted Decision (CFSP) 2016/1693 ⁽¹⁾.
- (2) In view of the continued threat posed by ISIL (Da'esh) and Al-Qaeda and persons, groups, undertakings and entities associated with them, two persons and one group should be added to the lists of persons, groups, undertakings and entities set out in the Annex to Decision (CFSP) 2016/1693.
- (3) Decision (CFSP) 2016/1693 should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

The Annex to Decision (CFSP) 2016/1693 is amended as set out in the Annex to this Decision.

*Article 2*This Decision shall enter into force on the date of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 30 May 2022.

For the Council
The President
C. COLONNA

⁽¹⁾ Council Decision (CFSP) 2016/1693 of 20 September 2016 concerning restrictive measures against ISIL (Da'esh) and Al-Qaeda and persons, groups, undertakings and entities associated with them and repealing Common Position 2002/402/CFSP (OJ L 255, 21.9.2016, p. 25).



ANNEX

The Annex to Decision (CFSP) 2016/1693 is amended as follows:

(1) the following entries are added under the heading 'A. Persons referred to in Articles 2 and 3':

- '10. Faruq AL-SURI (a.k.a. Samir Hijazi, Samir 'Abd al-Latif Hijazi, Abu Hammam Al-Shami, Abu Humam Al-Shami, Abu Hammam Al-'Askari); date of birth: 1977; place of birth: Damascus, Syria; gender: male; nationality: Syrian (presumed).
11. Sami AL-ARIDI (a.k.a. Abu Mohammad Al-Shami, Abu Mahmud Al-Sham, Abu Mahmud Al-Shami, Sami Al-Oride, Sami Al-Oraid, Sami Al-Oraid, Sheikh Dr. Sami Al-Uraydi); date of birth: 1973; gender: male; nationality: Jordanian (presumed).';

(2) the following entry is added under the heading 'B. Groups, undertakings and entities referred to in Article 3':

- '3. Hurras AL-DIN (HaD) (a.k.a. Hurras al-Deen, Huras-al-Din, Guardians of Religion, Tanzim Hurras Al-Din, Tandhim Hurras Al-Deen, Sham Al-Ribat, Al-Qaida in Syria, AQ-S).';



VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2022/1241 i datës 18 korrik 2022

përditësimi i listës së personave, grupeve dhe subjekteve që i nënshtrohen neneve 2, 3 dhe 4 të pozicionit të përbashkët 2001/931/CFSP mbi zbatimin e masave specifike për të luftuar terrorizmin dhe shfuqizimi i Vendimit (CFSP) 2022/152

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,
Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë,
Ndërsa:

- (1) Më 27 dhjetor 2001, Këshilli miratoi qëndrimin e përbashkët 2001/931/CFSP (1).
- (2) Më 3 shkurt 2022, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2022/152 (2), duke përditësuar listën e personave, grupeve dhe subjekteve që i nënshtrohen neneve 2, 3 dhe 4 të pozicionit të përbashkët 2001/931/CFSP ('listë').
- (3) Në përputhje me nenin 1(6) të pozicionit të përbashkët 2001/931/CFSP, është e nevojshme të rishikohen në intervale të rregullta emrat e personave, grupeve dhe subjekteve në listë për të siguruar që ka arsye për mbajtjen e tyre në të.
- (4) Ky Vendim përcakton rezultatin e rishikimit që Këshilli ka kryer në lidhje me personat, grupet dhe subjektet për të cilët zbatohen nenet 2, 3 dhe 4 të pozicionit të përbashkët 2001/931/CFSP.
- (5) Këshilli ka verifikuar që autoritetet kompetente, siç përmendet në nenin 1(4) të pozicionit të përbashkët 2001/931/CFSP, kanë marrë vendime në lidhje me të gjithë personat, grupet dhe subjektet në listë për efektin që ata kanë janë përfshirë në akte terroriste sipas kuptimit të nenit 1 (2) dhe (3) të Pozicionit të Përbashkët 2001/931/CFSP. Këshilli ka arritur gjithashtu në përfundimin se personat, grupet dhe entitetet për të cilët zbatohen nenet 2, 3 dhe 4 të Pozicionit të Përbashkët 2001/931/CFSP duhet të vazhdojnë të jenë subjekt i masave specifike kufizuese të parashikuara në Pozicionin e Përbashkët 2001/931/CFSP.
- (6) Lista duhet të përditësohet në përputhje me rrethanat dhe Vendimi (CFSP) 2022/152 duhet të shfuqizohet,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Lista e personave, grupeve dhe subjekteve për të cilat zbatohen nenet 2, 3 dhe 4 të pozicionit të përbashkët 2001/931/CFSP është paraqitur në aneksin e këtij vendimi..

Neni 2

Vendimi (CFSP) 2022/152 shfuqizohet.

- (1) (1) Pozicioni i përbashkët i Këshillit 2001/931/CFSP i 27 dhjetorit 2001 mbi zbatimin e masave specifike për të luftuar terrorizmin (OJ L 344, 28.12.2001, f. 93).
- (2) (2) Vendimi i Këshillit (CFSP) 2022/152 i datës 3 shkurt 2022 për përditësimin e listës së personave, grupeve dhe subjekteve që i nënshtrohen neneve 2, 3 dhe 4 të pozicionit të përbashkët 2001/931/CFSP për zbatimin e masave specifike për të luftuar terrorizmin, dhe shfuqizimi i Vendimit (CFSP) 2021/1192 (OJ L 25, 4.2.2022, f. 13).

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi një ditë pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bruksel, 18 korrik 2022.

Për Këshillin

President

J. BORRELL FONTELLES



ANEKS

LISTA E PERSONAVE, GRUPEVE DHE SUBJEKTEVE TË REFERUARA NË NENIN 1

I. PERSONAT

1. ABDOLLAHI Hamed (njohur ndryshe si Mustafa Abdullahi), i lindur më 11.8.1960 në Iran. Numri i pasaportës: D9004878.
2. AL-NASSER Abdelkarim Hussein Mohamed, lindur në Al Ihsa (Arabia Saudite), shtetas i Arabisë Saudite.
3. AL-YACOB Ibrahim Salih Mohammed, i lindur më 16.10.1966 në Tarut (Arabia Saudite), shtetas i Arabisë Saudite.
4. ARBABSIAIR Manssor (njohur ndryshe si Mansour Arbabsiar), i lindur më 6.3.1955 ose 15.3.1955 në Iran. Shtetasi iranien dhe amerikan, numri i pasaportës: C2002515 (Iran); Numri i pasaportës: 477845448 (SHBA). Numri i ID-së kombëtare: 07442833, data e skadencës 15.3.2016 (patent shoferi në SHBA).
5. ASSADI Assadollah (njohur ndryshe si Assadollah Asadi), i lindur më 22.12.1971 në Teheran (Iran), shtetas iranien. Numri i pasaportës diplomatike iraniane: D9016657.
6. BOUYERI Mohammed (njohur ndryshe si Abu Zubair, njohur ndryshe si Sobair, njohur ndryshe si Abu Zoubair), i lindur më 8.3.1978 në Amsterdam (Holandë).
7. EL HAJJ Hassan Hassan, i lindur më 22.3.1988 në Zaghdraiya, Sidon, Liban, shtetas kanadez. Numri i pasaportës: JX446643 (Kanada).
8. HASHEMI MOGHADAM Saeid, lindur më 6.8.1962 në Teheran (Iran), shtetas iranien. Numri i pasaportës: D9016290, i vlefshëm deri më 4.2.2019.
9. AL-DIN Izz Hasan (njohur ndryshe si Garbaya Ahmed, njohur ndryshe si Sa'id, njohur ndryshe si Salwwan Samir), Liban, lindur më 1963 në Liban, shtetas i Libanit.
10. MELIAD Farah, lindur më 5.11.1980 në Sydney (Australi), shtetas australian. Numri i pasaportës: M2719127 (Australi).
11. MOHAMMED Khalid Sheikh (njohur ndryshe si Ali Salem, njohur ndryshe si Bin Khalid Fahd Bin Abdallah, njohur ndryshe si Henin Ashraf Refaat Nabith, njohur ndryshe si Wadood Khalid Abdul), i lindur më 14.4.1965 ose 1.4.85, numri 1.3.19 në Pakistan.
12. SHAHLAI Abdul Reza (njohur ndryshe si Abdol Reza Shala'i, njohur ndryshe si Abd-al Reza Shalai, njohur ndryshe si Abdorreza Shahlai, njohur ndryshe si Abdolreza Shahlai, njohur ndryshe si Abdul-Reza Shahlae, njohur ndryshe si Hajxhif, Yuajif njohur ndryshe si, a.k. Yusif, i njohur si Jusuf Abu-al-Karkh), i lindur rreth vitit 1957 në Iran. Adresat: (1) Kermanshah, Iran, (2) Baza Ushtarake Mehran, Provinca Ilam, Iran.
13. SHAKURI Ali Gholam, i lindur rreth vitit 1965 në Teheran, Iran.

II. GRUPET DHE ENTITETET

1. Organizata 'Abu Nidal' - 'ANO' (a.k.a. 'Këshilli Revolucionar i Fatahut', a.k.a. 'Brigadat Revolucionare Arabe', a.k.a. 'Shtatori i Zi', a.k.a. 'Organizata Revolucionare e Muslimanëve Socialiste').
2. Brigada e dëshmorëve të Al-Aksës.
3. 'El-Aksa e.V.'.
4. 'Babbar Khalsa'.
5. 'Partia Komuniste e Filipineve', duke përfshirë 'Ushtrinë e Re Popullore' - 'NPA', Filipine.
6. Drejtoria për Sigurinë e Brendshme të Ministrisë iraniane për Inteligjencë dhe Siguri.
7. 'Gama'a el-Islamiyya' (a.k.a. 'Al-Gama'a al-Islamiyya') ('Grupi Islamik' - 'IG').
8. 'islami Buyuk Dogu Akincilar Cephesi' - 'IBDA-C' ('Fronti i Madh i Luftëtarëve të Lindjes Islamiqe').
9. 'Harnasi', duke përfshirë 'Harnas-Izz al-Din al-Kassem'.
10. 'Krahu Ushtarak i Hizbollahut' (i njohur ndryshe si 'krahu ushtarak i Hezbollahut', i njohur si 'krahu ushtarak i Hizbollahut', i njohur si 'krahu ushtarak i Hizbollahut', a.k.a. 'krahu ushtarak i Hezbollahut', a.k.a. 'krahu ushtarak i Hizb Allah', a.k.a.



'Këshilli i Xhihadit' (dhe të gjitha njësitë që i raportojnë atij, duke përfshirë Organizatën e Sigurisë së Jashtme)).

11. 'Hizbul Muxhahidin' – 'HM'.
12. 'Khalistan Zindabad Force' – 'KZF'.
13. 'Partia e Punëtorëve të Kurdistanit' - 'PKK' (a.k.a. 'KADEK', a.k.a. 'KONGRA-GEL').
14. 'Tigrat e çlirimit të Tamil Eelam' - 'LTTE'.
15. 'Ejercito de Liberation National' ('Ushtria Çlirimtare Kombëtare').
16. 'Xhihadi Islamik Palestinez' – 'PIJ'.
17. 'Fronti Popullor për Çlirimin e Palestinës' – 'PFLP'.
18. "Fronti Popullor për Çlirimin e Palestinës - Komanda e Përgjithshme" (a.k.a. "PFLP - Komanda e Përgjithshme").
19. 'Devrimci Halk Kurtulus Partisi-Cephesi' - 'DHKP/C' (a.k.a. 'Devrimci Sol' ('Emajta Revolucionare'), a.k.a. 'Dev Sol') ('Ushtria/Fronti/Partia Revolucionare Popullore Çlirimtare').
20. 'Sendero Luminoso' - 'SL' ('Shtegu i ndritshëm').
21. 'Teyrbazen Azadiya Kurdistan' - 'TAK' (a.k.a. 'Skifterat e Lirisë së Kurdistanit', a.k.a. 'Skifterat e Lirisë së Kurdistanit').



19.7.2022

EN

Official Journal of the European Union

L 190/133

COUNCIL DECISION (CFSP) 2022/1241

of 18 July 2022

updating the list of persons, groups and entities subject to Articles 2, 3 and 4 of Common Position 2001/931/CFSP on the application of specific measures to combat terrorism, and repealing Decision (CFSP) 2022/152

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 27 December 2001, the Council adopted Common Position 2001/931/CFSP ⁽¹⁾.
- (2) On 3 February 2022, the Council adopted Decision (CFSP) 2022/152 ⁽²⁾, updating the list of persons, groups and entities subject to Articles 2, 3 and 4 of Common Position 2001/931/CFSP ('the list').
- (3) In accordance with Article 1(6) of Common Position 2001/931/CFSP, it is necessary to review at regular intervals the names of persons, groups and entities in the list to ensure that there are grounds for keeping them thereon.
- (4) This Decision sets out the result of the review that the Council has carried out in respect of persons, groups and entities to which Articles 2, 3 and 4 of Common Position 2001/931/CFSP apply.
- (5) The Council has verified that competent authorities, as referred to in Article 1(4) of Common Position 2001/931/CFSP, have taken decisions with regard to all persons, groups and entities on the list to the effect that they have been involved in terrorist acts within the meaning of Article 1(2) and (3) of Common Position 2001/931/CFSP. The Council has also concluded that the persons, groups and entities to which Articles 2, 3 and 4 of Common Position 2001/931/CFSP apply should continue to be subject to the specific restrictive measures provided for in Common Position 2001/931/CFSP.
- (6) The list should be updated accordingly and Decision (CFSP) 2022/152 should be repealed,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

The list of persons, groups and entities to which Articles 2, 3 and 4 of Common Position 2001/931/CFSP apply is set out in the Annex to this Decision.

Article 2

Decision (CFSP) 2022/152 is hereby repealed.

⁽¹⁾ Council Common Position 2001/931/CFSP of 27 December 2001 on the application of specific measures to combat terrorism (OJ L 344, 28.12.2001, p. 93).

⁽²⁾ Council Decision (CFSP) 2022/152 of 3 February 2022 updating the list of persons, groups and entities subject to Articles 2, 3 and 4 of Common Position 2001/931/CFSP on the application of specific measures to combat terrorism, and repealing Decision (CFSP) 2021/1192 (OJ L 25, 4.2.2022, p. 13).



Article 3

This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 18 July 2022.

For the Council
The President
J. BORRELL FONTELLES

—



ANNEX

LIST OF PERSONS, GROUPS AND ENTITIES REFERRED TO IN ARTICLE 1

I. PERSONS

1. ABDOLLAHI Hamed (a.k.a. Mustafa Abdullahi), born 11.8.1960 in Iran. Passport number: D9004878.
2. AL-NASSER Abdelkarim Hussein Mohamed, born in Al Ihsa (Saudi Arabia), citizen of Saudi Arabia.
3. AL-YACoub Ibrahim Salih Mohammed, born 16.10.1966 in Tarut (Saudi Arabia), citizen of Saudi Arabia.
4. ARBABSIAr Manssor (a.k.a. Mansour Arbabsiar), born 6.3.1955 or 15.3.1955 in Iran. Iranian and US national, Passport number: C2002515 (Iran); Passport number: 477845448 (USA). National ID number: 07442833, expiry date 15.3.2016 (USA driving licence).
5. ASSADI Assadollah (a.k.a. Assadollah Asadi), born 22.12.1971 in Teheran (Iran), Iranian national. Iranian diplomatic passport number: D9016657.
6. BOUYERI Mohammed (a.k.a. Abu Zubair, a.k.a. Sobiar, a.k.a. Abu Zoubair), born 8.3.1978 in Amsterdam (The Netherlands).
7. EL HAJJ Hassan Hassan, born 22.3.1988 in Zaghdraiya, Sidon, Lebanon, Canadian citizen. Passport number: JX446643 (Canada).
8. HASHEMI MOGHADAM Saeid, born 6.8.1962 in Teheran (Iran), Iranian national. Passport number: D9016290, valid until 4.2.2019.
9. AL-DIN Izz Hasan (a.k.a. Garbaya Ahmed, a.k.a. Sa'id, a.k.a. Salwwan Samir), Lebanon, born 1963 in Lebanon, citizen of Lebanon.
10. MELIAD Farah, born 5.11.1980 in Sydney (Australia), Australian citizen. Passport number: M2719127 (Australia).
11. MOHAMMED Khalid Sheikh (a.k.a. Ali Salem, a.k.a. Bin Khalid Fahd Bin Abdallah, a.k.a. Henin Ashraf Refaat Nabith, a.k.a. Wadood Khalid Abdul), born 14.4.1965 or 1.3.1964 in Pakistan, passport number 488555.
12. SHAHLAI Abdul Reza (a.k.a. Abdol Reza Shala'i, a.k.a. Abd-al Reza Shalai, a.k.a. Abdorreza Shahlai, a.k.a. Abdolreza Shahla'i, a.k.a. Abdul-Reza Shahlaee, a.k.a. Hajj Yusef, a.k.a. Haji Yusif, a.k.a. Hajji Yasir, a.k.a. Hajji Yusif, a.k.a. Yusuf Abu-al-Karkh), born circa 1957 in Iran. Addresses: (1) Kermanshah, Iran, (2) Mehran Military Base, Ilam Province, Iran.
13. SHAKURI Ali Gholam, born circa 1965 in Tehran, Iran.

II. GROUPS AND ENTITIES

1. 'Abu Nidal Organisation' – 'ANO' (a.k.a. 'Fatah Revolutionary Council', a.k.a. 'Arab Revolutionary Brigades', a.k.a. 'Black September', a.k.a. 'Revolutionary Organisation of Socialist Muslims').
2. 'Al-Aqsa Martyrs' Brigade'.
3. 'Al-Aqsa e.V.'.
4. 'Babbar Khalsa'.
5. 'Communist Party of the Philippines', including 'New People's Army' – 'NPA', Philippines.
6. Directorate for Internal Security of the Iranian Ministry for Intelligence and Security.
7. 'Gama'a al-Islamiyya' (a.k.a. 'Al-Gama'a al-Islamiyya') ('Islamic Group' – 'IG').
8. 'İslami Büyük Doğu Akıncılar Cephesi' – 'İBDA-C' ('Great Islamic Eastern Warriors Front').



9. 'Hamas', including 'Hamas-Izz al-Din al-Qassem'.
10. 'Hizballah Military Wing' (a.k.a. 'Hezbollah Military Wing', a.k.a. 'Hizbullah Military Wing', a.k.a. 'Hizbollah Military Wing', a.k.a. 'Hezbollah Military Wing', a.k.a. 'Hisbollah Military Wing', a.k.a. 'Hizbu'llah Military Wing' a.k.a. 'Hizb Allah Military Wing', a.k.a. 'Jihad Council' (and all units reporting to it, including the External Security Organisation)).
11. 'Hizbul Mujahideen' – 'HM'.
12. 'Khalistan Zindabad Force' – 'KZF'.
13. 'Kurdistan Workers' Party' – 'PKK' (a.k.a. 'KADEK', a.k.a. 'KONGRA-GEL').
14. 'Liberation Tigers of Tamil Eelam' – 'LTTE'.
15. 'Ejército de Liberación Nacional' ('National Liberation Army').
16. 'Palestinian Islamic Jihad' – 'PIJ'.
17. 'Popular Front for the Liberation of Palestine' – 'PFLP'.
18. 'Popular Front for the Liberation of Palestine – General Command' (a.k.a. 'PFLP – General Command').
19. 'Devrimci Halk Kurtuluş Partisi-Cephesi' – 'DHKP/C' (a.k.a. 'Devrimci Sol' ('Revolutionary Left'), a.k.a. 'Dev Sol' ('Revolutionary People's Liberation Army/Front/Party')).
20. 'Sendero Luminoso' – 'SL' ('Shining Path').
21. 'Teyrbazen Azadiya Kurdistan' – 'TAK' (a.k.a. 'Kurdistan Freedom Falcons', a.k.a. 'Kurdistan Freedom Hawks').



VENDIMET

VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2022/950 i datës 20 qershor 2022

për ndryshimin e Vendimit (CFSP) 2016/1693 në lidhje me masat kufizuese kundër ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaedës dhe personave, grupeve, ndërmarrjeve dhe subjekteve të lidhura me ta

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punë të Jashtme dhe Politikë të

Sigurisë, Ndërsa:

- (1) Më 20 shtator 2016, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2016/1693 (1).
- (2) Duke pasur parasysh kërcënimin e vazhdueshëm të paraqitur nga ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaeda, dhe personat, grupet, ndërmarrjet dhe subjektet e lidhura me ta, tre persona dhe një grup duhet të shtohen në listën e personave, grupeve, ndërmarrjeve dhe subjekteve të përcaktuara në Aneksin e Vendimit (CFSP) 2016/1693.
- (3) Prandaj, Vendimi (CFSP) 2016/1693 duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Aneksi i Vendimit (CFSP) 2016/1693 është ndryshuar siç përcaktohet në Aneksin e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bërë në Luksemburg, 20 qershor 2022.

Për Këshillin

President

J. BORRELL FONTELLES

(1) Vendimi i Këshillit (CFSP) 2016/1693 i 20 shtatorit 2016 në lidhje me masat kufizuese kundër ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaedës dhe personave, grupeve, ndërmarrjeve dhe subjekteve të lidhura me ta dhe shfuqizimin e Pozicionit të Përbashkët 2002/402/CFSP (OJ L 255, 21.9.2016, f. 25).



ANEKSI

Aneksi i Vendimit (CFSP) 2016/1693 është ndryshuar si më poshtë:

(1) shënimet e mëposhtme janë shtuar nën titullin 'A. Personat e përmendur në nenet 2 dhe 3':

- '12. Sidan Ag HITTA (i njohur ndryshe si Asidan Ag Hitta, Abu 'Abd al-Hakim, Abu Abdelhakim al-Kidali, Abu Qarwani, Al Qaïrawani, Abou Abdel Hamid Al Kidali); data e lindjes: 1976; vendlindja: Kidal, Mali; Gjinia mashkull; kombësia: Malian.
13. Salem ould BREIHMATT (i njohur ndryshe si OULD ABED Cheikh ould Mohamed Salec, Abu Hamza al-Shanqiti, Abu Hamza al-Shinqiti, Hamza al-Mauritani, NITRIK Hamza, Abu Hamza al-Chinguetti); data e lindjes: 1978 ose 1984; vendi i lindjes: Mauritania; Gjinia mashkull; kombësia: Mauritanian.
14. Jafar DICKO (i njohur ndryshe si Jaffar Dicko, Abdoul Salam Dicko, Amadou Boucary, Amadou Boucary Dicko); data e lindjes: 1980 (presumuar); Gjinia mashkull; kombësia: Burkinabe.';

(2) shënimi i mëposhtëm shtohet nën titullin 'B. Grupet, ndërmarrjet dhe subjektet e përmendura në nenin 3':

- '4. Ansarul Islam (i njohur ndryshe si Ansar al-Islam, Ansarour Islam, Ansaroul Islam, Mbrojtësit e Islamit, Ansar-ul-islam lil-ichad wal jihad, IRSAD, Ansar ul Islam of Malam Boureima Dicko).'



DECISIONS

COUNCIL DECISION (CFSP) 2022/950

of 20 June 2022

amending Decision (CFSP) 2016/1693 concerning restrictive measures against ISIL (Da'esh) and Al-Qaeda and persons, groups, undertakings and entities associated with them

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 20 September 2016, the Council adopted Decision (CFSP) 2016/1693 ⁽¹⁾.
- (2) In view of the continued threat posed by ISIL (Da'esh) and Al-Qaeda, and persons, groups, undertakings and entities associated with them, three persons and one group should be added to the list of persons, groups, undertakings and entities set out in the Annex to Decision (CFSP) 2016/1693.
- (3) Decision (CFSP) 2016/1693 should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

The Annex to Decision (CFSP) 2016/1693 is amended as set out in the Annex to this Decision.

Article 2

This Decision shall enter into force on the date of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Luxembourg, 20 June 2022.

For the Council

The President

J. BORRELL FONTELLES

⁽¹⁾ Council Decision (CFSP) 2016/1693 of 20 September 2016 concerning restrictive measures against ISIL (Da'esh) and Al-Qaeda and persons, groups, undertakings and entities associated with them and repealing Common Position 2002/402/CFSP (OJ L 255, 21.9.2016, p. 25).



20.6.2022

EN

Official Journal of the European Union

L 164 I/5

ANNEX

The Annex to Decision (CFSP) 2016/1693 is amended as follows:

(1) the following entries are added under the heading 'A. Persons referred to in Articles 2 and 3':

12. Sidan Ag HITTA (a.k.a. Asidan Ag Hitta, Abu 'Abd al-Hakim, Abu Abdelhakim al-Kidali, Abu Qarwani, Al Qairawani, Abou Abdel Hamid Al Kidali); date of birth: 1976; place of birth: Kidal, Mali; gender: male; nationality: Malian.
13. Salemould BREHMATT (a.k.a. OULD ABED Cheikhould Mohamed Salec, Abu Hamza al-Shanqiti, Abu Hamza al-Shingiti, Hamza al-Mauritani, NITRIK Hamza, Abu Hamza al-Chinguetti); date of birth: 1978 or 1984; place of birth: Mauritania; gender: male; nationality: Mauritanian.
14. Jafar DICKO (a.k.a. Jaffar Dicko, Abdoul Salam Dicko, Amadou Boucary, Amadou Boucary Dicko); date of birth: 1980 (presumed); gender: male; nationality: Burkinabe;.

(2) the following entry is added under the heading 'B. Groups, undertakings and entities referred to in Article 3':

4. Ansarul Islam (a.k.a. Ansar al-Islam, Ansarour Islam, Ansaroul Islam, Defenders of Islam, Ansar-ul-islam lil-ichad wal jihad, IRSAD, Ansar ul Islam of Malam Boureima Dicko);.

VENDIM

Nr. 639, datë 5.10.2022

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË
GRANTIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM,
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT
“HEKURUDHAT SHQIPTARE –
REHABILITIMI I LINJËS
HEKURUDHORE TIRANË–DURRËS
DHE NDËRTIMI I LINJËS
HEKURUDHORE PËR NË AEROPORTIN
NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS”, NË
KUADËR TË GRANTIT TË INVESTIMIT
NGA FONDI I PËRBASHKËT EVROPIAN
I BALLKANIT PERËNDIMOR,
RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 52/2018**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19, e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare – Rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, në kuadër të grantit të investimit nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor, ratifikuar me ligjin nr. 52/2018, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**



LOGOJA E EBRD-së

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bul. Dëshmorët e Kombit 3
Tiranë
SHQIPËRI

Drejtuar: Ministrit të Financave dhe Ekonomisë

Faks: + 355 4 222 8494

8 nëntor 2021

Të nderuar Zotërinj,

**Lënda: Hekurudhat Shqiptare
Veprimi Nr. 48466**

1. Ju lutem referojuni:

- (i) marrëveshjes së huasë të datës 29 dhjetor 2016 ("Marrëveshja e Huasë") ndërmjet Republikës së Shqipërisë ("Huamarrësi") dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka");
 - (ii) Termave dhe Kushteve Standarde ("ST&C") të datës 1 dhjetor 2012 që përbëjnë pjesë integrale të Marrëveshjes së Huasë;
 - (iii) marrëveshjes së projektit të datës 17 maj 2017 ("Marrëveshja e Projektit") ndërmjet Hekurudha Shqiptare SH.A. ("Njësia e Projektit") dhe Bankës; dhe
 - (iv) Marrëveshjes së Grantit të datës 7 maj 2018, të ndryshuar nga Amendamenti i Marrëveshjes nr. 1, datë 19 shtator 2019 ("Marrëveshja e Grantit") ndërmjet Huamarrësit (në cilësinë e tij si "Përfituesi") dhe Bankës;
2. Fjalët dhe shprehjet e përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë, ST&C, Marrëveshjen e Projektit dhe Marrëveshjen e Grantit kanë të njëjtat kuptime kur përdoren në këtë shkresë, përveç nëse parashikohet ndryshe ose kur konteksti kërkon ndryshe. Referencat në këtë shkresë për një klauzolë janë për klauzolën e specifikuar të kësaj shkrese.
3. Seksioni 2.02(f) i Marrëveshjes së Huasë thekson se Data Përfundimtare e Vlefshmërisë do të jetë data katër vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje apo një datë më e vonshme që Banka, me kërkesë të Huamarrësit dhe me diskrecionin e saj, mund të caktojë dhe njoftojë Huamarrësin.



4. Seksioni 2.02(a) i Marrëveshjes së Huasë thekson se e drejta e Marrësit për të kërkuar një disbursim në përputhje me këtë Marrëveshje, do të hyjë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi dhe do të përfundojë në datën më të hershme të (i) datës përfundimtare të disponueshmërisë për kredinë e Bankës për Projektin (siç përshkruhet në Marrëveshjen e Huasë) të specifikuar në Seksionin 2.02 (f) (Kushtet e tjera financiare të huasë) të Marrëveshjes së Huasë ose (ii) 31 dhjetor 2025, ose një datë tjetër të mëvonshme që Banka, sipas gjykimit të saj dhe me marrëveshjen e Përfituesit, mund të vendosë dhe njoftojë Marrësin.
5. Më 8 nëntor 2021, me anë të një shkresë të veçantë, Banka ra dakord të zgjasë Datën Përfundimtare të Disponueshmërisë të specifikuar në seksionin 2.02(f) të Marrëveshjes së Huasë deri më 20 dhjetor 2025.
6. Si rrjedhojë, Banka pranon të zgjasë datën përfundimtare të disponueshmërisë për huanë e Bankës të specifikuar në seksionin 2.02(a) të Marrëveshjes së Grantit deri më 20 dhjetor 2025.
7. Përmbajtja e kësaj shkrese nuk do të cenojë asnjë të drejtë, fuqi ose mjet juridik të Bankës në lidhje me ndonjë kusht tjetër sipas Marrëveshjes së Huasë dhe as nuk do të interpretohet si heqje dorë prej saj ose pranim të saj.

Me respekt,

Azmat Khurshid
Drejtor i Asociuar
Departamenti i Administratës Operative

Rënë dakord dhe pranuar nga Huamarrësi:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____
Emri: _____
Pozicioni: _____

Nga: _____
Emri: _____
Pozicioni: _____



VENDIM
Nr. 640, datë 5.10.2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË
HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR
FINANCIMIN E PROJEKTIT
“HEKURUDHAT SHQIPTARE –
REHABILITIMI I LINJËS
HEKURUDHORE TIRANË–DURRËS
DHE NDËRTIMI I LINJËS
HEKURUDHORE PËR NË AEROPORTIN
NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS”,
RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 29/2017

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare – Rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, ratifikuar me ligjin nr. 29/2017, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, 3
Tiranë
SHQIPËRI

Drejtuar: Ministrit të Financave dhe Ekonomisë

Faks: + 355 4 222 8494

8 nëntor 2021

Të nderuar zotërinj,

Lënda: Hekurudhat Shqiptare
Veprimi nr. 48466

1. Ju lutem referojuni:

i. Marrëveshjes së Huas të datës 29 dhjetor 2016 (“Marrëveshja e Huas”) ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Huamarrësi”) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”);

ii. Termat dhe Kushtet Standarde (“ST&C”) të datës 1 dhjetor 2012, që përbëjnë pjesë integrale të Marrëveshjes së Huas;

iii. Marrëveshjes së Projektit të datës 17 maj 2017 (“Marrëveshja e Projektit”) ndërmjet Hekurudha Shqiptare sh.a. (“Njësia e Projektit”) dhe Bankës; dhe

iv. Marrëveshjes së Grantit të datës 7 maj 2018, të ndryshuar nga Amendamenti Marrëveshjes nr. 1, datë 19 shtator 2019 (“Marrëveshja e Grantit”) ndërmjet Huamarrësit (në cilësinë e tij si “Përfituesi”) dhe Bankës;

2. Fjalët dhe shprehjet e përcaktuara në Marrëveshjen e Huas, ST&C, Marrëveshjen e Projektit dhe Marrëveshjen e Grantit kanë të njëjtat kuptime, kur përdoren në këtë shkresë, përveç nëse parashikohet ndryshe ose kur konteksti kërkon ndryshe. Referencat në këtë shkresë për një klauzolë janë për klauzolën e specifikuar të kësaj shkrese.

3. Seksioni 2.02(f) i Marrëveshjes së Huas thekson se Data Përfundimtare e Vlefshmërisë do të jetë data katër vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje apo një datë mëvonshme që Banka, me kërkesë të Huamarrësit dhe me diskrecionin e saj, mund të caktojë dhe të njoftojë Huamarrësin.

4. Banka pranon të zgjasë Datën Përfundimtare të Disponueshmërisë të specifikuar në seksionin 2.02(f) të Marrëveshjes së Huas deri më 20 dhjetor 2025.



5. Kjo letër nuk cenon ose modifikon në asnjë mënyrë detyrimet e shlyerjes së Huamarrësit, sipas seksionit 2.02(e) të Marrëveshjes së Huas ose nuk modifikon ndonjë detyrim tjetër të Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas.

6. Përmbajtja e kësaj shkrese nuk do të cenojë asnjë të drejtë, fuqi ose mjet juridik të Bankës, në lidhje me ndonjë kusht tjetër, sipas Marrëveshjes së Huas dhe as nuk do të interpretohet si heqje dorë prej saj ose pranim të saj.

Me respekt,
Azmat Khurshid
Drejtor i Asociuar
Departamenti i Administratës Operative

Rënë dakord dhe pranuar nga Huamarrësi:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____
 Emri: DELINA IBRAHIMAJ
 Pozicioni: MINISTËR I FINANCave
 DHE EKONOMISË
 13.7.2022

Nga: _____
 Emri:
 Pozicioni

VENDIM
Nr. 641, datë 5.10.2022

**PËR NJË SHITESË NË NUMRIN E
 PUNONJËSVE ORGANIKË TË
 MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS
 DHE ENERGJISË, PËR VITIN 2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për vitin 2022, shtohet me 35 (tridhjetë e pesë) veta dhe numri i përgjithshëm i sistemit të ministrisë bëhet 1 188 (një mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë) veta.

Faqe | 16736

2. Numri i punonjësve rezervë të buxhetit pakësohet me 35 (tridhjetë e pesë) veta dhe numri i përgjithshëm i punonjësve rezervë mbetet 15 (pesëmbëdhjetë) veta.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 642, datë 5.10.2022

**PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË
 KRYETARIT TË AGJENCISË
 KOMBËTARE TË TRAJTIMIT TË
 KONCESIONEVE**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të pikës 8/1, të vendimit nr. 285, datë 10.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për organizmin, funksionimin, si dhe procedurat e nivelin e tarifave të shërbimeve që do të ofrohen nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Emiliano Gjika emërohet kryetar i Agjencisë të Trajtimit të Koncesioneve.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

**VENDIM****Nr. 643, datë 5.10.2022****PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES DHE
TË MËNYRËS SË FUNKSIONIMIT TË
KOMITETIT PËR PLANIFIKIMIN
KOMBËTAR SPITALOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 6, të ligjit nr. 55/2022, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

Vendosi:

1. Përcaktimin e përbërjes dhe të mënyrës së funksionimit të Komitetit për Planifikimin Kombëtar Spitalor, si organ këshillimor pranë ministrit përgjegjës për shëndetësinë, me 9 anëtarë, si më poshtë vijon:

- | | |
|-----------------------------|-------------------------------------|
| a) Prof. Arben Gjata | mjek kirurg; |
| b) Prof. Anila Godo | mjek pediatër; |
| c) Prof. Dr. Kozeta Sevrani | ekspert i ekonomisë dhe menaxhimit; |
| d) Prof. Arben Baboci | mjek kirurg kardiak; |
| e) Prof. Asc. Durim Çela | mjek radiolog; |
| f) Prof. Mihal Tase | mjek internist; |
| g) Prof. Dr. Orion Glozheni | mjek obstetër-gjinekolog; |
| h) Prof. Ass. Edmond Zaimi | mjek urgjentist; |
| i) Prof. Asc. Alban Ylli | profesionist i shëndetit publik; |

2. Anëtarët e Komitetit për Planifikimin Kombëtar Spitalor zgjidhen për një periudhë 3-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

3. Komiteti për Planifikimin Kombëtar Spitalor, gjatë veprimtarisë së tij, asistohet nga sekretari i këtij komiteti, i cili është një specialist pranë drejtorisë përgjegjëse për politikën dhe menaxhimin e shërbimit spitalor në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë.

4. Kryetari dhe nënkryetari i komitetit zgjidhen nga anëtarët e këtij komiteti në mbledhjen e parë me shumicë votash.

5. Komiteti për Planifikimin Kombëtar Spitalor mblidhet me kërkesë të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe kryen këto funksione:

- Analizon situatën aktuale të shtrirjes së shërbimit spitalor në vend;
- Vlerëson nevojat dhe kapacitetet spitalore kombëtare, bazuar në kriteret territoriale,

demografike, socioekonomike, barrën e sëmundshmërisë, si edhe në plotësim të kërkesave didaktike dhe shkencore të edukimit mjekësor;

c) Paraqet për shqyrtim pranë ministrit Planin Kombëtar Spitalor;

ç) Jep mendime për çështjet e përcaktuara në nenin 6, të ligjit nr. 55/2022, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe për çështje të tjera që lidhen me politikën spitalore të kërkuara nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

6. Vendimet e komitetit merren me shumicën e të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

7. Vendimi nr. 403, datë 19.6.2004, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe mënyrën e funksionimit të Komitetit Shtetëror për Planifikimin Spitalor”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIMI**Nr. 644, datë 5.10.2022****PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E
NJOHJES SË NDËRSJELLË TË
DIPLOMAVE DHE GRADAVE
SHKENCORE, TË LËSHUARA NGA
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË
LARTË DHE INSTITUCIONET E TJERA
TË AUTORIZUARA NË BALLKANIN
PERËNDIMOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes për bashkëpunim në fushën e njohjes së ndërsjellë të diplomave dhe gradave shkencore, të lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e tjera të autorizuar në Ballkanin Perëndimor, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



MARRËVESHJE

PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E
NJOHJES SË NDËRSJELLË TË
DIPLOMAVE DHE GRADAVE
SHKENCORE, TË LËSHUARA NGA
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË
DHE INSTITUCIONET E TJERA
TË AUTORIZUARA NË BALLKANIN
PERËNDIMOR

Ne, pjesëmarrësit e Ballkanit Perëndimor, të referuar bashkërisht si “Palët Kontraktuese” dhe individualisht si “Pala Kontraktuese”,

Të nxitur nga dëshira dhe nevoja për të promovuar bashkëpunimin produktiv në fushën e përbashkët të njohjes së ndërsjellë të diplomave dhe të gradave shkencore të lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e tjera të autorizuara;

Duke respektuar legjislacionin e brendshëm në fuqi ndërmjet Palëve Kontraktuese, si dhe parimet dhe standardet ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve të përcaktuara në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare;

Duke marrë parasysh vlerat dhe interesat e ngjashëm, si dhe nevojën për bashkëpunim në fushën e njohjes së ndërsjellë të diplomave, bazuar në barazinë dhe përfitimin e ndërsjellë;

Duke ftuar pjesëmarrësit e tjerë të Ballkanit Perëndimor që t'i bashkohen kësaj marrëveshjeje në frymën e gjithëpërfshirjes dhe të bashkëpunimit rajonal, me synimin për të nxitur bashkëpunimin produktiv në fushën e njohjes së ndërsjellë të diplomave dhe certifikatave brenda rajonit,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi dhe përkufizimet

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të lehtësojë bashkëpunimin institucional në fushën e njohjes së diplomave dhe gradave shkencore të arsimit të lartë, të fituara në Palët Kontraktuese, ndërmjet zyrave ENIC/NARIC, me qëllim lehtësimin e procedurave të njohjes.

Termi “diplomë” nënkupton dokumentin përfundimtar të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, sipas legjislacionit në fuqi të çdo Pale Kontraktuese, i cili vërteton përfundimin me sukses të një programi

studimi ose arritjen e një kualifikimi që i përket nivelit 5, kur është i zbatueshëm në një prej Palëve Kontraktuese dhe nivelet 6 deri në 8 të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, pavarësisht nga emri i dokumentit.

Termi “diplomë shkencore” nënkupton kualifikimin “Doktor”, i cili vërteton përfundimin me sukses të një programi studimi ose arritjen e një kualifikimi, që i përket nivelit 8, sipas Kornizës Evropiane të Kualifikimeve.

Neni 2

Institucionet përgjegjëse

Institucioni përgjegjës në Republikën e Shqipërisë për njohjen e diplomave të fituara jashtë vendit (përveç gradës shkencore “Doktor”) është Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë. Institucioni përgjegjës për njohjen në Republikën e Shqipërisë të gradës shkencore “Doktor”, të fituar jashtë vendit, është Ministria e Arsimit dhe Sportit. Sekretaria Teknike për këtë shërbim ndodhet pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Institucioni përgjegjës për njohjen në Republikën e Serbisë është Agjencia e Kualifikimeve (Qendra ENIC/NARIC) për njohje profesionale (me qëllim punësimin) dhe institucionet e arsimit të lartë të akredituara në Republikën e Serbisë për njohjen akademike (me qëllim vazhdimin e studimeve).

Institucioni përgjegjës për njohjen në Republikën e Maqedonisë së Veriut është Ministria e Arsimit dhe Shkencës-Njësia për Njohjen e Kualifikimit të Diplomës së Huaj.

Neni 3

Metodat e bashkëpunimit

Bashkëpunimi institucional, në fushën e njohjes së ndërsjellë të diplomave dhe të gradave shkencore të lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë, do të realizohet nëpërmjet:

a) Bashkëpunimit për lehtësimin e njohjes së diplomave dhe gradave shkencore të arsimit të lartë, të fituara në Palët Kontraktuese;

b) Shkurtimeve të afateve të ndërsjella për procedurat e njohjes së diplomave dhe të gradave



shkencore të arsimit të lartë, të fituara në Palët Kontraktuese.

Neni 4

Lehtësimi i procedurave dhe i afateve

a) Për diplomat e lëshuara nga institucionet e akredituara të arsimit të lartë, të pajisura me vulë Apostile, institucionet përgjegjëse të procedojnë drejtpërdrejt me njohjen, pa pasur nevojë për verifikimin me *e-mail* të autenticitetit të diplomës. Përgjashtimisht, në rastet kur ka dyshime të arsyeshme për autenticitetin e dokumentacionit, secila Palë Kontraktuese rezervon të drejtën të kërkojë konfirmim në rrugë elektronike nga Pala tjetër Kontraktuese.

b) Afati për konfirmimin e autenticitetit të diplomës është deri në 14 ditë pune pas paraqitjes së kërkesës nga Pala tjetër.

c) Afati i përfundimit të procesit të njohjes së diplomës është deri në 20 ditë pune, pas konfirmimit të autenticitetit të diplomës ose paraqitjes së saj me vulën Apostile.

Neni 5

Zbatimi i Marrëveshjes

Bashkëpunimi i parashikuar në këtë Marrëveshje do të zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi të Palët Kontraktuese, si dhe në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtare për njohjen e kualifikimeve të përcaktuara në instrumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, pjesë e të cilave janë Palët Kontraktuese.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet negociatave.

Neni 7

Dispozitat përfundimtare dhe kalimtare

Republika e Maqedonisë së Veriut do të veprojë si Depozitar i kësaj Marrëveshjeje.

Marrëveshja do të hyjë në fuqi në ditën e njoftimit të fundit me të cilin Palët Kontraktuese informojnë Depozitarin, se procedurat e tyre të

brendshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes janë përmbyshur.

Marrëveshja mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të të gjitha Palëve Kontraktuese.

Marrëveshja do të mbetet në fuqi për një kohë të pacaktuar.

Çdo Palë Kontraktuese mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje, duke e njoftuar Depozitarin, me shkrim, për qëllimin e saj për t'u tërhequr. Në këtë rast, Marrëveshja do të pushojë së qeni në fuqi për atë Palë Kontraktuese në ditën e 30 (të tridhjetë) pas datës së marrjes së njoftimit nga Depozitari.

Originali i kësaj Marrëveshjeje në një kopje të vetme në gjuhën angleze dhe do të depozitohet te Depozitari, i cili do t'i transmetojë një kopje të vërtetuar secilës Palë Kontraktuese.

Nënshkruar në Ohër, më 8 qershor 2022.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Për Qeverinë e Republikës së Serbisë

Për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut

VENDIM

Nr. 645, datë 5.10.2022

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2022, MIRATUAR PËR MINISTRINË E KULTURËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, t'i shtohet fondi prej 15 600 000 (pesëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind mijë) lekësh, në formën e grantit për Akademinë e Filmit dhe Multimedias "Marubi", për mbështetjen e veprimtarive krijuese.



2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, në masën 15 600 000 (pesëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Ministrisë së Kulturës, i miratuar për vitin 2022, në artikullin 604, “Transferta të brendshme”, të programit “Arti dhe kultura”.

3. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë për zbatimin e këtij vendimi.

K y vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë